



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-13311/22  
Kaçanik, 23.05.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V (pestë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23 maj 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, dhe Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj pa arsye, Ardita Rrahmani.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive: Qamil Stagova- DUKMM, Dardana Tafili-Dauti –DAP, Hafize Sallahi-DKRS, Zahir Doda-DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, ndërkaq nga zyrtarët ishte Fadil Guri-koordinator i Zyrës për kthim dhe komunitete.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.  
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune për me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V (pestë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data, 23 maj, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Draft-Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut;
3. Programi komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025;
4. Plani komunal për integritet 2022-2026;
5. Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Materiali në KPF na ka ardhur me 6 pikë, ndërkaq ai i mbledhjes së në KK me 7 pikë, ku është arsyeja?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja është se, Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Samedin Rexha ka kaluar procedurën e KPF, e njëjta shqyrtohet vetëm në KK. Diskutime tjera nuk ka, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

**APROVON**

**Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes së aprovuar:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj. Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**APROVON**

**Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 22.04.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-10511/22.**

2. Draft-Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, draft rregullorja e ka kaluar dëgjimet publike sipas rregullave ligjore që parashihet dhe e njëjta është sjellë në KPF dhe KK për shqyrtim dhe aprovim. Para se me hapur diskutimin, për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtoresha, Hafize Sallahi.

**znj. Hafize Sallahi:** Iu njoftoj se për hartimin e draft rregullores fillimisht është formuar një komision prej 7 anëtarëve, me angazhimin e tyre kemi arritur me nxjerrë një draft rregullore e cila për bazë e ka rregulloren e ministrisë së kulturës, rinisë dhe sportit. Drafti është marrë si mostër nga tre komuna. Rregullorja ka qenë në diskutim publik me 19 maj, ku në bazë të kërkesave të qytetarëve janë bërë 2-3 ndryshime të vogla në draft. Tani e kemi nxjerrë draftin përfundimtar dhe e kemi proceduar për shqyrtim në KPF dhe KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Sa ka me qenë numri i të punësuarve në palestër, sepse di duket, palestra ka me qenë funksionale deri në orët e vona? A ka me pasur staf shtesë, se është vështirë me u menaxhuar palestra sportive me stafin aktual që e ka ?

**znj. Hafize Sallahi:** Rregullorja nuk e parasheh numrin e të punësuarve, rregullorja është për shfrytëzimin e palestrës sportive. Momentalisht janë 2 punëtorë teknik me orar nga 8-16, është sigurimi 24 orë. Në bazë të kësaj rregulloreje, secili që e përdorë palestrën sportive, është sigurimi ai i cili paraqet tek ne çdo parregullsi për shfrytëzim të palestrës. E kemi planifikuar pranimin e një punëtorit teknik, jemi në hapje të konkursit, besoj që do të jetë në ndërrim të pasdites. Po ashtu edhe në stadiumin e qytetit "Besnik Begunca" e kemi një punëtor i cili punon të shtunave dhe të dielave, ndërkaq zëvendësohet kur nuk ka ushtrime.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Çështja e organizimit të brendshëm është e përcaktuar me organogram, ndërkaq rregullorja është për shfrytëzimin e hapësirave të palestrës sportive. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim draft rregulloren me ia kaluar KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi që KPF, e

**Aprovoj**

**Draft-Rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut. Të njëjtin ia**

**Rekomandon**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

3. Programi komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në mungesë të drejtorit, programin do t'na sqaron zyrtari për kthim dhe komunitete, Fadil Guri. Fillimisht e hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** A hynë në këtë program të banimit edhe objektet të cilat u janë dhënë në shfrytëzim familjeve të dëshmorëve?

**z. Fadil Guri:** Me Ligjin 03/L-164, të gjitha komunat janë të obliguara me pasur programin e banimit. Në program aktual janë të evidentuara të gjitha banesat kolektive dhe njësitë banesore të cilat mund të shfrytëzohen atëherë kur kanë hapësira. Në pyetjen konkrete, këtu nuk kemi ndërhyrë, sepse çështja është se disa janë prona private që sipas mendimit tim dhe të komisionit (një anëtar i komisionit ka qenë inxhinier), aty nuk bënë të ndërhyjmë për shkak se e kemi të bëjmë me një kategori shumë të prekur. Janë marrë disa hapa menjëherë pas luftime, janë vendosur qytetarët në objekte banesore, mbështetje nga institucionet nuk ka pasur mundësi me iu dhënë, ndërkaq për prona private është diçka tjetër, vendosë gjykata, ato nuk hyjnë në këtë plan, por hyjnë të gjitha objektet tjera me evidencë dhe në momentin kur për nevoja - raste ekstreme që na ndodhin, me u përdorur, ne nuk e kemi të drejtën me i përdorur, por atyre që iu duhet, si për ndonjë ndezje objekti, e që mbetet në rrugë, aty pastaj fillojnë kalkulimet e ideve sesa duhet komuna të subvencionoj objektin që e merr në shfrytëzim, nga çmimi i tregut. Rregulloret dhe Udhëzimet administrative janë sesi do të procedohet që ta mbështesin dhënien në shfrytëzim të objekteve, por dhënie me qira me ia paguar komuna në përgjithësi nuk ka.

**z. Agim Mani:** D.m.th. komuna i merr përsipër menaxhimin e objekteve në çfarëdo rasti, kur dihet se pronat janë private apo qysh e ceke me herët.

**z. Fadil Guri:** Në rastin konkret, nëse x-iks pësonit i ndodhë diçka, si në rastin e ndonjë tërmeti a vërshime, në mundësitë tona që i kemi, duhet me shikuar ata që kanë mundësi me dhënë pronën me qira. Çmimet kontraktohen me familjarin, çmimi kalkulohet nga çmimi ofertues deri 25%ka të drejtë me subvencionuar komuna objektin që e merr personi me qira. Objektet të cilat i kemi në shfrytëzim, ato janë me qira, por jo qira fitimprurëse e profitabile, por me u dhënë një qira simbolike që edhe ata që e marrin në shfrytëzim që janë pronar të përhershme, për momentin janë të obliguar me e lëshuar banesën.

**z. Agim Mani:** Kategoritë me të ndishme (familjet e dëshmorëve), si duket po mbesin në pozitë me të vështirë sa i përket çështjes se banimit.

**z. Fadil Guri:** Ata të cilët janë duke banuar në banesa, por nuk e kanë të zgjidhur çështjen pronësore juridike, kanë të drejtë me aplikuar si raste, por janë kriteret për dhënien e tyre, por çështja pronësore juridike prishë punë.

**z. Agim Mani:** Kategoria e familjeve të dëshmorëve munden me ngelur në pozitë shumë me të keqe sesa rastet sociale sa i përket çështjes së banimit.

Të çështja e migrimit, kur është bërë ky regjistër? Nuk po hy në detaje, por po e marr një shembull, në Australi janë vetëm 17 vetë, ndërkaq e di unë vetëm sa familjarë të mi, janë që 40 apo 50 vite atje. Të dhënat e paraqitura nuk janë as të përafërta. Duhet me kërkuar përgjegjësi nga ata ku i keni marrë të dhënat, ndërkaq ata që i kanë dhënë të dhënat, duhet kërkuar përgjegjësi diku tjetër, që me pasur regjistra së paku të përafërta.

**z. Fadil Guri:** Regjistrime të migrimit të sakët nuk mundet me i pasur as enti statistikor, ndërkaq të përafërta pa.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të dhënat janë marrë sigurisht nga enti i statistikave. Mundet me qenë numri shumë i madh, por të dhënat janë marrë nga institucionet në formë zyrtare. Secili institucion punon në bazë të listave që i ka në regjistra. Ka mundësi ata që janë me vendqëndrim në Australi nuk janë në regjistra. Ne mundemi në secilin shtet mos me pasur të dhënat e sakta. Regjistrat e banimit rezidentë dhe jo rezidentë, janë në regjistrat e enteve statistikore dhe në regjistra të gjendjes civile. Burimet e të dhënave merren nga ta, ndërkaq a janë a nuk janë aty, nuk e di, por nuk besoj se janë se me pas qenë, ishin të dhënat. Nëse nuk janë, edhe familjarët e tyre me pas bërë këtë dokument, nuk kishin mundur me shënuar, pa qenë e faktume me dokument. Nëse nuk është e faktume me dokument, nuk është zyrtare ajo. Nëse nuk janë të dhënat në entin statistikor dhe në regjistra të gjendjes civile që ata persona janë jo rezidentë, atëherë nuk mundesh me shkruar së është me vendbanim në Australi, nuk mundesh me shkruar edhe nëse e dinë se duhet me pasur gjendjen e faktume, se nuk mundesh me faktuar nëse dikush që jeton jashtë nga familjarët e tu, nëse nuk është e faktume në institucione të Kosovës, të enti statistikor apo të gjendja civile. Këto janë dy burime që munden me i hulumtuar, dhe ne duhet me u bazuar në këto të dhëna.

**Kadije Lika-Troni:** Pajtohem me mendimin e z. Agim Mani, se nëse me statistika gjendja e personave është me e vogël, ne e kemi gjendjen civile këtu dhe kur këta persona vijnë me nxjerrë dokumente, është lehtë me i identifikuar personat rezident se ku jetojnë. Ne nuk mundemi me folur me statistike të cilat janë bërë para 5 apo 6 viteve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Gjendja e statistikave në komunën tonë në zgjedhje, numri i votuesve na del e barabartë me numrin e banorëve, ndërkaq nuk jemi ne institucion që mundemi me i përmirësuar këtë gjendje.

**Kadije Lika-Troni:** Si komunë nuk mundemi me i ndryshuar gjendje, por veprime mundem me marrë, me bërë një identifikim të kësaj kategorie që me i pasur statistikat e qytetarëve të komunës tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për derisa Parlamenti i Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk e kanë zgjedhur këtë problematikë, ne nuk mundemi me zgjidhur. Kjo çështje është trajtuar në parlamentin e Kosovës, është trajtuar çështja e votuesve, ndërkaq ne si institucion i nivelit lokal nuk jemi kompetent me trajtuar këtë çështje.

**z. Kadri Krivenjeva:** Ne e dimë migrimin e rinisë, familjeve në nivel komune, personat të cilët janë në perëndim. Shumica e tyre rrinë ilegal jashtë vendit, kështu është e pamundur me pasur një shifër reale të qytetarëve të komunës tonë se ku janë. A duhet me punuar në këtë drejtim për me

ditur gjendjen reale ? Po, duhet me punuar në këtë drejtim që me qenë shifrat sa më të përafërta, e mërgimtarëve tanë kudo që gjenden ata.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju jeni anëtarë të KK dhe e dini që secili akt që vjen në KK duhet me pasur burimin e informacionit i cili duhet me qenë zyrtar. Besoj se komisioni e ka marrë burimin e informacionit kur ka shënuar këtë shifër, sepse nuk mundën me punuar pa burim të informacionit. E dimë gjendjen reale krejt edhe krejt e dinë gjendjen e faktume, se kjo është e trajtuar gati në çdo institucion, se ka qenë problematike puna e zgjedhjeve, për shkak se numri i votuesve ka dalë i barabartë me numrin e banorëve, ndërkaq të drejtë vote kanë qytetarët mbi moshën 18 vjeç. Kjo çështje është neglizhuar që sa vjet, shpresojmë të zgjidhet.

**z. Sabedin Vishi:** Krejt pajtohem që gjendja reale dhe faktike nuk është në bazë të këtyre shifrave, mirëpo duhet me u pajtua se ne si komunë nuk kemi plan me bërë regjistrimin e popullsisë. Komuna bazohet në shifrat zyrtare të cilat janë bërë kur është bërë regjistrimi i popullsisë. A ka numër të banorëve që kanë dalë në perëndim ? Po, nëse i marrim vetëm 3 vitet e fundit, e dimë se ka numër jashtëzakonisht të madh, por ne bazohemi në të dhënat zyrtare në regjistrimet e popullsisë të vitit 2011. Komuna nuk bënë plan për regjistrimin e popullsisë, por duhet me pritur planin e qeverisë kur të bëhet për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës.

**znj. Kadrije Lika- Troni:** A keni pasur kërkesa nga kategoria e dhunës në familje, më iu gjetur strehim, pasi që në komunën tonë, mungon një strehimore, ku në këtë rast zakonisht përjashtohen gratë. Nëse ndodhë një dhunë në familje, gratë dalin nga shtëpia me fëmijët, ndërkaq çështja është se ku shkojnë ato, se mund të mbesin me muaj e me vjet pa strehim. A ka pasur kërkesa për këtë kategori me iu gjetur banim komuna dhe a është menduar me u gjetur një strehimore për këtë lloj kategorie?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me sa e di unë, janë vendet e caktuara për strehimore për këto kategori, të cilat strehimore nuk janë publike. Është një strehimore ne Ferizaj me duket, ndërkaq është obligim i ministrisë që merret me këto çështje në bashkëpunim me ministrinë e punëve të brendshme dhe entit social. Në komunën tonë nuk ka strehimore të këtij lloji, ndërkaq një statistikë e vitit të kaluar e nxjerrë komunën tonë në nivel të Kosovës me rastet me të vogla të dhunës në familje. Sa është reale nuk e di, se vendi jonë është më në periferi e mund te mos i lajmërojnë rastet, në krahasim me mentalitetin e kryeqytetit etj.

**z. Fadil Guri:** Ka strehimore për strehimin e kategorive të tilla, është në Ferizaj, vepron si OJQ, menaxhohet nga një femër, ajo kryesisht mjetet buxhetore i merr nga një OJQ ndërkombëtare, por edhe komuna jonë ka ndihmuar me një shumë simbolike, diku 500 apo 1000 euro në vit. Ajo strehimore është për Ferizaj, Hanin e Elezit, Kaçanik, Shtërpçë dhe Shtime, ndërkaq iu shërben qytetarëve. Nëse ndodhë ndonjë rast, me këtë çështje kryesisht merret QPS – zyrtari kompetent në bashkëpunim me policinë, rastet e tilla i dërgojnë në atë strehimore, derisa të rregullohet çështja e strehimit. Emrin nuk ia di asaj strehimoreje për momentin, por e kam një dokument se kam qenë ushtrues detyre në DSHPS për mbështetje ligjore, por tani nuk jam, se është një zyrtare e punësuar në DSHMS.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky program pune t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Programin komunal trevjeçar të banimit për vitet 2022-2025. I njëjti i,  
Rekomandohet**

## **Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

### **4. Plani komunal për integritet 2022-2026;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komunitat janë të obliguara të hartojnë plane të integritetit në çdo 3 apo 4 vite. Me herët nuk kanë qenë ky obligim i komunave, ndërkaq në këto viteve e fundit janë bërë obliguese hartimi i këtyre planeve, për shkak se janë obligative me treguesit e kërkuar për grantin e performancës. Sa përmbushen këto plane, mbetet me pa, drejtoresha është këtu, fjalën e ka drejtoresha e DAP, Dardana Tafili-Dauti.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Ne e kemi formuar një grup punues në përbërje prej 5 anëtarëve i cili është marrë me hartimin e këtij plani, pastaj është caktuar një koordinator i cili merret me përcjelljen e zbatimit të këtij plani, i cili zyrtar i raporton kryetarit në çdo 3 muaj. Nëse ai e vëren se nuk po zbatohet plani apo ka vështirësi në zbatim, atëherë nuk do të thotë se ky plan ka me qenë për 4 vjet, mundet të jetë vetëm për 1 vit apo 2 vite. Plani zhvillohet në 4 faza, janë fushat e përgjithshme dhe specifike që i parasheh plani. Është një plan i mirë për komunitat e Kosovës, disa komuna e kanë hartuar planin e integritetit, ndërkaq disa janë në proces të hartimit të tij.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Plan të integritetit ka pasur edhe me herët, por i ka skaduar afati. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** Nëse nuk zbatohet ky plan, atëherë llogari jep koordinatori i cili është përgjegjës për zbatimin e tij.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Në momentin e hartimit të planit, përgjegjësia kalon tek koordinatori, i cili monitoron, e vlerëson situatën dhe raporton. Përgjegjës për realizimin e këtij plani është e koordinatorit.

**z. Agim Mani:** A janë raportet obligative për zbatimin e këtij plani ?

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Raportet nuk janë obligative, por si informatë mundemi me i përcjellë në KK. Obligative e ka koordinatori me i raportuar kryetarit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Obligim për zbatimin e këtij plani në KK ka kryetari i komunës, e jo koordinatori.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Realisht ky plan nuk është obligativ për komunën. Në bazë të informacioneve të cilat unë i kam pasur në takimin e fundit, mund të jam gabim, se ende disa komuna nuk e kanë hartuar planin, janë në proces të hartimit. Në bazë të takimeve të cilat i kemi pasur në MAPL, nuk ka një kohë të caktuar se kur duhet hartohet ky plan, ndërsa koordinatori ka përgjegjësi me monitoruar dhe vlerësuar se a po zbatohet ky plan apo jo. Raportimin koordinatori e bënë të kryetari, por si informatë plani mund të përcjellët në KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Plani i integritetit është obligativ me u zbatuar. Planet e integritetit tani kanë hyrë në diskutime dhe obligime në 3 apo 4 vitet e fundit. Komuna ka pasur plan të integritetit edhe para këtij plani, tani atij plani i ka skaduar afati. Komunitat udhëhiqen nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale (LVL) dhe në ligj nuk parashihet plani i integritetit, për shkak se LVL është aprovuar në vitin 2008, ndërkaq nga atëherë nuk ka pësuar asnjë ndryshim edhe pse kërkesat dhe nevojat janë shumë të mëdha me u ndryshuar, por çështja është se ky ligj është specifik dhe kërkon miratimin edhe 2/3 e pakicave, kështu që asnjëherë nuk kanë mundur institucionet me marrë

veprime me u ndryshuar ky ligj. Atëherë në pamundësi për të përfshirë edhe çështje tjera në ligj, lind nevoja përmes akteve tjera nënligjore me rregulluar çështje. MAPL ka paraparë që komunat të kenë plan të integritetit, për arsye se është një rrugë që e parandalon rrezikun e korrupsionit dhe keqpërdorimeve e kështu me radhë. Komunat nga 2018, kanë marrë shkresa nga MAPL për me hartuar plan të integritetit, sa e di unë plane të integritetit kanë pasur gati krejt komunat. Se a kemi obligim me pasur planin e integritetit, është e përcaktuar në treguesit e performancës, ata që nuk kanë plan nuk poentohen në këtë fushë, kjo tregon se planet duhet të hartohen nga komuna. Kryetari e cakton një koordinator për me mbikëqyrë zbatimin e planit të integritetit. Koordinator i raporton kryetarit për zbatimin e planit të integritetit. Plani miratohet në KK, ndërkaq kryetari i raporton KK për zbatimin e planit. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky plan t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Planin komunal për integritet 2022-2026. Ky plan i,  
Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**5. Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është prezent në mbledhje, fillimisht ia jap fjalën drejtorit për sqarime të nevojshme.

**z. Zahir Doda:** Është kërkesë e ministrisë së arsimit me i harmonizuar të gjitha shkollat e mesme profesionale-ShMP, qysh e përcakton ligji. Ligji e njih këto institucione arsimore si Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional – IAAP, për shkak që mos me u kontestuar në të ardhmen ndonjë diplomë e lëshuar nga ky institucion. Nuk ndërrohet emri i shkollës, por ndryshohet thirrja, për këtë arsye, propozim vendimit ia kam bashkangjitur edhe vendimin për emërtimin e SHMP. Thirrja, Shkolla e mesme profesionale –SHMP, hiqet, ndërkaq shtohet thirrja: Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional – IAAP.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka të interesuar me marrë fjalën, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Kërkoj të di se a ndërrohet emërtimi i shkollës ?

**z. Zahir Doda:** Nuk ndryshohet emri i shkollës, por ndryshohet thirrja e shkollës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Emri i shkollës nuk ndryshohet, por ndryshohet thirrja e shkollës. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK për shqyrtim dhe aprovim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim-Vendimin për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Ky propozim vendim i,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Në bazë të cilit ligj po merren vendimet për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të ligjit për planifikim hapësinor apo në bazë të ligjit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?

**z. Qamil Stagova:** Ndërrimet e destinimeve të tokave bujqësore bëhen në bazë të ligjit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevshet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë. Ky propozim Vendim i,**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:52. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF sa ishin edhe në fillim. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31 Maj 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*

